



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 060/3
Prishtinë, më 12 e 13 shkurt 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 12 DHE 13 SHKURT 2009**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmuan **Xhavit Haliti** dhe **Xhezair Murati**, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 67 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 29 e 30 janar dhe më 2 shkurt 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,

3. Zgjedhja e Avokatit të Popullit,
4. Rishqyrtimi i Ligjit për Avokatinë,
5. Rishqyrtimi i Ligjit për Lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare, nr. 03/L- 134,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor,
9. Debati sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare, dhe
10. Propozimi i GP të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 29 e 30 janar dhe më 2 shkurt 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 29 e 30 janar dhe më 2 shkurt 2009.

Deputetja Gjylnaze Syla pati vërejtje në Transkript, në faqen 136, që është përmirësuar, sipas sugjerimit të saj.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Rita Hajzeraj-Beqaj** parashtroi pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me pagat e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj

Deputetja **Gjylnaze Syla** parashtroi pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me strukturat paralele serbe në Kosovë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputetja **Myrvete Pantina** parashtroi pyetje për ministrin për Ekonomi dhe Financa, Ahmet Shala, lidhur me ndërtimin e stacionit të pompave për furnizim me ujë të pijes në hyrje të qytetit të Vushtrrisë.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputetja **Kosara Nikolić** parashtroi pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me ndërtimet në tokën e Kooperativës bujqësore “Ratar” në Llaplla Sellë.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Nikolić.

Deputetja **Zylfije Hundozi** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kewlmendi, lidhur me hartimin e Projektligjit për procedurat ekzekutive.

Ministrja Nekibe Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Kosara Nikolić** i parashtoi pyetje ministrit të Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami, lidhur me proceduar e dhënies së certifikatave nga libri amë i të lindurve.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Nikoliq.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje ministrit të Kulturës, Valton Beqiri, lidhur me rivarrosjen e eshtrave të Isa Boletinit.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me numrin e lëndëve gjyqësore të pakryera.

Ministrja Nekibe Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi lidhur me problematikën e papërputhshmërisë së teksteve të akteve juridike në gjuhët zyrtare të vendit tonë.

Zëvendëskryeministrit Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

3. Zgjedhja e Avokatit të Popullit

Kryetari i njoftoi deputetët me Raportin dhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të Panelit rekrutues për zgjedhjen e tre kandidatëve për pozitën e Avokatit të Popullit.

Ai ftoi kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, që ta arsyetojë raportin.

Bahri Hyseni tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Rregullës 9 të Rregullave të procedurës së Kuvendit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe në bazë Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të datës 18 nëntor 2008, me të cilin ngarkohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, që në bashkëveprim me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, si komisione të përhershme, bashkërisht të formojnë Panelin rekrutues për Avokatin e Popullit. Ne kemi formuar Panelin rekrutues, i cili është i përbërë nga të gjitha grupet parlamentare të cilat janë në Kuvend. Panelin rekrutues e ka udhëhequr kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në Kuvendin e Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

Punën e Panelit rekrutues gjatë vlerësimit të CV-ve të kandidatëve dhe gjatë intervistës e kanë mbështetur edhe Zyra e Komisionarit të lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Sekretarit të Këshillit të Evropës, si dhe të gjitha organizatat të cilat e mbështesin Kuvendin e Kosovës.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, pasi ka marrë Raportin përfundimtar nga Paneli Intervistues, më datën 20 janar 2009 e ka shqyrtuar raportin, me të gjitha propozimet që kanë ardhur dhe duke u bazuar në rregullat për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, i rekomandon Kuvendit të Kosovës këta kandidatë për Avokat të Popullit:

- Hilmi Jashari,
- Diana Toska, dhe
- Veton Vula.

Kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret sipas rregullave aktuale që janë në fuqi.

Pastaj, **Kryetari** kërkoi nga grupet parlamentare që të caktojnë nga një përfaqësues në Komisionin votues.

Grupi Parlamentar i PDK-së, propozoi deputetin Hajredin Hyseni,
Grupi Parlamentar i LDK-së, propozoi deputetin Ismet Beqiri,
Grupi Parlamentar i AKR-së, propozoi deputeten Suzana Novobrdaliu,
Grupi Parlamentar i LDD-së, propozoi deputetin Naser Rugova,
Grup Parlamentar “7+”, propozoi deputeten Shpresa Murati,
Grupi Parlamentar i SLS-së, propozoi deputeten Kosara Nikoliq, dhe
Grupi Parlamentar “Zajedno”, propozoi deputetin Dragisha Miriq, si dhe dy zyrtarë nga stafi i Administratës, Xheladin Hoxha dhe Suzana Maksimoviq, për ta ndihmuar punën e komisionit.

Kryetari i njoftoi deputetët me procedurat e votimit për Avokatin e Popullit, që parashohin që votimi të jetë i fshehtë.

Ai ftoi një nga një deputetët që të votonin. Pas përfundimit të procedurës së votimit, Komisioni i votimit i numëroi votat një nga një. Në fund, deputeti Ismet Beqiri, në emër të Komisionit votues prezantoi rezultatin e votimit, si vijon:

Kanë votuar 103 deputetë.

- Për kandidatin Hilmi Jashari, kanë votuar 15 deputetë,
- Për kandidaten Diana Toska, kanë votuar 28 deputetë,
- Për kandidatin Veton Vula, kanë votuar 31 deputetë,

Kurse të pavlefshme ishin 29 fletëvotime.

Kryetari tha se në bazë të këtij rezultati, procedura e votimit duhet të përsëritet vetëm për dy kandidatët të cilët kanë fituar më së shumti vota.

Ai ftoi një nga një deputetët që të votonin për dy kandidatët për Avokat të Popullit.

Pas përfundimit të procedurës së votimit, Komisioni i votimit i numëroi votat një nga një. Në fund, deputeti Ismet Beqiri, në emër të Komisionit votues prezantoi rezultatin e votimit, si vijon:

Kanë votuar 89 deputetë.

- Për kandidaten Diana Toska, kanë votuar 26 deputetë,
- Për kandidatin Veton Vula, kanë votuar 40 deputetë,

Kurse të pavlefshme ishin 23 fletëvotime.

Kryetari tha se për t’u zgjedhur Avokat i Popullit, kandidatin duhet ta votojnë 61 deputetë.

Në raundin e tretë të votimit do të votojmë vetëm për kandidatin i cili ka fituar më së shumti vota.

Ai ftoi një nga një deputetët që të votonin për kandidatin që ka fituar më së shumti vota.

Pas përfundimit të procedurës së votimit, në emër të Komisionit të votimit, deputeti Ismet Beqiri prezantoi rezultatet e votimit si vijon:

Gjithsej kanë votuar 92 deputetë.

- Për kandidatin Veton Vula, kanë votuar 37 deputetë,
- Kundër, 30 kanë votuar deputetë,
- Të pavlefshme, 25 fletëvotime.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk zgjodhi asnjërin kandidatë për Avokat të Popullit.

Kryesia e Kuvendit duhet ta rishpallë konkursin për Avokatin e Popullit.

4. Rishqyrtimi i Ligjit për Avokatinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kuvendi kishte miratuar Ligjin për Avokatinë, më 20 nëntor 2008 dhe ia kishte dërguar Presidentit të Kosovës, për shpallje.

Presidenti, në afatin kohor prej 10 ditësh, ia kishte kthyer Kuvendit Ligjin në rishqyrtim, me vërejtjet konkrete. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi kishte shqyrtuar vërejtjet e Presidentit në Ligjin për Avokatinë dhe Kuvendit ia kishte paraqitur Raportin me rekomandime.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentin nr. 1.

“Për” votuan 57 deputetë. Ai e hodhi në votim amendamentin nr. 2. Rezultati i votimit ishte “për” 57 vota.

Kryesuesi konstatoi se në bazë të këtij rezultati Kuvendi nuk i miratoi amendamentet e propozuara në Ligjin për Avokatinë. Për miratimin e ndryshimeve në Ligjin e kthyer nga Presidenti, sipas rregullave procedurale, duhet të votojnë 61 deputetë

5. Rishqyrtimi i Ligjit për Lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit dt. 30 korrik 2008, për procedimin e ligjeve të pashpallura ka ngarkuar komisionin funksional për ta rishqyrtuar tekstin e Ligjit për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare.

Komisioni ka rishqyrtuar Ligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin e Komisionit funksional e arsyetoi deputetja Melihate Tprmkolli.

Kryetari hodhi amendamentet e propozuara në votim, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5,, 6, 7, 8, 9, 10,. 11, 12, 13, 14, 15, 156, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 46, 47, 48, 49, 50, 51 dhe 52.

Kryetari e hodhi në votim Ligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

- Për73,
- Kundër.....1,
- Abstenime.....0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për lirinë e asocimit në organizatat joqeveritare.

6.Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin e dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, si dhe me raportin dhe rekomandimet e komisionit funksional.

Kryetari hodhi në votim amendamentin nr. 1, të cilin e miratoi Kuvendi.

Kryetari e hodhi në votim Ligjin me amendamentin e miratuar. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për73
- Kundër..... 0
- Abstenime..... 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ushqimin

Kryetari i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji, si dhe me raportet dhe rekomandimet e komisioneve parlamentare.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5,, 6, 7, 8, 9, 10,. 11, 12, 13, 14, 15, 156, 17, 18, 19, 20, 21 dhe 22.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për71
- Kundër..... 0
- Abstenime..... 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ushqimin.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor

Kryetari i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, si dhe me Raportin dhe rekomandimet e komisionit funksional.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5,, 6, 7, 8, 9, 10,, 11, 12 dhe 13.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

- Për70,
- Kundër..... 0,
- Abstenime..... 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Kryetari e deklaroi Seancën të mbyllur në ora 18,00 për t'i vazhduar punimet nesër.

E premte, 13 shkurt 2009

Vazhdimi i seancës

9. Debati sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të AAK-së ta marrë fjalën.

Kryetari të Grupit të AAK-së, **Ardian Gjini**, tha se kanë kërkuar debatin me qëllim që të sqarohen të gjitha arsyet dhe procedurat që kanë sjell deri te vendimi i Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve deri në vitin 2011. Ne mendojmë se ky vendim është i gabueshëm, është jashtëligjor dhe ka konsekuenca të gabueshme politike për këto arsye:

E para është, dilema se a ka pasur marrëveshje? Fillimisht, në Grupin politik strategjik kemi biseduar për zgjedhjet, por nuk kemi biseduar për mandatin e parë të zgjedhjeve, kemi biseduar se sa duhet të zgjatë mandati në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Raporti përfundimtar i Grupit punues tranzitor mbi zgjedhjet ka dalë me rekomandime për sistemin zgjedhor, për listat e hapura ose të mbyllura, për dalje në zona zgjedhore, ku thotë vetëm një zonë duhet të jetë, për përfaqësimin gjinor 30%, çdo e treta, zgjedhja e drejtpërdrejtë e kryetarëve të komunave, si duhet të regjistrohen partitë politike, cilët janë mekanizmat e ankesave, cili është tranzicioni i Komisionit Qendror Zgjedhor, dhe cila është koha e zgjedhjeve të ardhshme, një nga pikat e fundit, ku përveç tjerave thuhet: “Grupi ka shënuar rekomandimin

e Ekipit të Unitetit për të organizuar zgjedhjet, 6 muaj pas miratimit të rezolutës së re”. Kjo është një marrëveshje që ka ekzistuar.

Marrëveshje tjetër për zgjedhjet është Marrëveshja e Pokantikos. Në te, në pikën 9 thuhet: “Nënshkruesit dakordohen që do ta mbështesin aprovimin e ligjit të ri për zgjedhjet dhe do të shpallin zgjedhjet lokale dhe të përgjithshme, jo më larg se 6 muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës”.

Çështja e dytë është, cilat janë provizionet kushtetuese dhe ligjore të cilat janë thyer me këtë vendim?

Neni 22 dhe 23 i Kushtetutës, thotë: “Të gjitha autoritet e Republikës së Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës”- plani i Ahtisarit. Pika e dytë thotë: “Dispozitat e Propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, kanë epërsinë ndaj të gjitha dispozitave tjera ligjore në Kosovë”. Pika e tretë thotë: “Kushtetuta, ligjet, aktet tjera të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007. Në rast se ka mospajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute dhe ligjeve e akteve të tjera të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.”

Neni 10 i Propozimit gjithëpërfshirës të Planit të Ahtisarit, thotë: “Jo më vonë se 9 muaj nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje, Kosova do të organizojë zgjedhje të përgjithshme dhe komunale në pajtim me kushtet e kësaj marrëveshjeje.”

Neni 4.1 i këtij propozimi, po ashtu, thotë: “Kryetari i Kosovës do të përfaqësojë unitetin e popullit të Kosovës.”

Neni 4.1 i Ligjit për zgjedhjet në Kosovë, thotë: “Presidenti i Republikës e cakton datën e zgjedhjeve pas konsultimeve me partitë politike”. Presidenti ynë nuk e ka parë të arsyeshme as t’i konsultojë partitë politike.

Çështja e tretë, është aspekti politik dhe pozicioni politik i Presidentit. A është presidenti i gjithë popullit të Kosovës, a nuk është, apo është presidenti i pushtetit? Nëse është presidenti i pushtetit, atëherë ne e kuptojmë, mirëpo nëse presidenti duhet ta përfaqësojë unitetin e popullit, presidenti e ka obligim të paktën, që të konsultohet me të gjitha partitë politike në Kosovë.

Dhe, e fundit, arsyet pse kërkohen zgjedhjet për shkak se këto tri të parat në vetvete japin të drejtën e mbajtjes së zgjedhjeve. Ka pasur marrëveshje, është Grupi punues që zgjedhjet të shpallen 6 muaj pas shpalljes së pavarësisë. Është shkelur Kushtetuta dhe Ligji për zgjedhjet.

Presidenti i Kosovës, nëse e do vendin, është dashur të mendojë për shpallje të zgjedhjeve, se mënyra se si po qeveriset ky vend, mënyra se si po punohet në këtë shtet e ri të Kosovës, nuk premtan kurrfarë të ardhme për qytetarët e Kosovës dhe vetëm zgjedhjet demokratike mund ta ndërrojnë kursin e qeverisjes së vendit.

Kryetari hapi debatin. Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së përkitazi me vendimin e Presidentit të Kosovës për shtyrjen e zgjedhjeve parlamentare, dhanë: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të

AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati** dhe në emër të Grupit parlamentar “Zajedno” **Sllavisha Petković**, si dhe deputetët: **Gjylnaze Syla, Numan Baliq, Adem Salihaj, Rasim Selmanaj, Naser Rugova, Jakup Krasniqi, Gani Geci, Bahri Hyseni, Besa Gaxherri, Rustem Mustafa, Zef Morina, Mark Krasniqi, Driton Tali, Ahmet Isufi, Naim Maloku, Kaqusha Jashari, Riza Smaka, Berim Ramosaj, Ibrahim Selmanaj, Gani Buçinca, Teuta Hadri, Berat Luzha, Ramadan Avdiu, Sadik Idriz, Myfera Shinik dhe Sabri Hamiti**, të cilët janë dhënë në transkripto, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në fund, në emër të propozuesit të mocionit, kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, përmbylli debatin dhe tha se ne mendojmë që në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka qenë dashur të shpallen zgjedhjet parlamentare. Po ashtu, ne mendojmë se në bazë të asaj se çka shohim ne se si po qeveriset vendi, është dashur të ngutemi për shpalljen zgjedhjeve. Këto janë mendime tona që i kemi thënë prej fillimit.

10. Propozimi i GP të AAK-së dhe të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimet e grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Grupi Parlamentar i AAK-së kishte propozuar që deputeti **Ibrahim Selamnaj** të emërohet anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, në vend të deputetit Naim Maloku, kurse deputeti **Naim Maloku** të emërohet anëtar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Ibrahim Selamanaj.

Grupi Parlamentar i PDK-së kishte propozuar që deputeti **Berat Luzha** të emërohet anëtar i Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit, në vend të deputetit Fehmi Mujota.

Kuvendi miratoi propozimet për zëvendësimet e anëtarëve të komisioneve parlamentare të cekura më lart.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**